

VENDIM
Nr.475, datë 14.10.1999

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR.473, DATË
29.9.1993 “PËR TË DREJTAT E PUNONJËSVE TË PËRFAQËSIVE DIPLOMATIKE TË
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË SHTETET E HUAJA DHE PËR SHPENZIMET E
UDHËTIMIT DHE TË DIETËS PËR PERSONAT QË DALIN JASHTË SHTETIT”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 4 e 8 pika 3 të ligjit nr.7870, datë 13.10.1994 “Për sigurimet shëndetësore në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e Ministrisë së Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave.

VENDOSI:

Në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.473, datë 29.9.1993 pika 7 ndryshohet si vijon:
“Ministra e Punëve të Jashtme për punonjësit e përfaqësive tona jashtë shtetit dhe bashkëshortët e tyre, si dhe fëmijët parashkollorë, ka të drejtë të bëjë sigurimin shëndetësor, si dhe sigurime të tjera të detyrueshme të shtetit përkatës.

Punonjësit e përfaqësive tona jashtë shtetit dhe bashkëshortët e tyre, si dhe fëmijët parashkollorë, kanë të drejtë që për raste urgjencash të mjekohen në vendin ku ndodhet përfaqësia, me miratim të titullarit të përfaqësisë, kur për një shërbim të tillë nuk është parashikuar sigurimi shëndetësor. Për raste të tjera, shpenzimet përballohen nga punonjësit e përfaqësisë.”

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Pandeli Majko